



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 10, dt. 18/12/2020

**MBI MIRATIMIN E DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2021-2023 PËR KËSHILLIN E QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 date 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes të PBA”, Ligjit për buxhetin e vitit 2021, Udhëzimit nr. 10 datë 28.02.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”, Udhëzimit nr. 27 date 10.07.2020 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”, Vendimeve të Këshillit të Qarkut nr. 1 date 30.03.2020 “Mbi miratimin e taveve përgatitore të PBA 2021-2023”, Vendimit të Këshillit të Qarkut nr 5 date 30.07.2020 “Mbi përgatitjen dhe miratimin e kërkesave buxhetore të PBA 2021-2023 për Këshillin e Qarkut”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë dokumentin përfundimtar të Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 për Këshillin e Qarkut Korçë, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
2. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit përfundimtar të PBA 2021-2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik, Shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

Konceptoi L.Pleqi
Juristi Gj. Kristo
Sek.K.qarkut B. Muço



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RAPORT

MBI PËRGATITJEN DHE MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TE
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2021-2023

Grupi i Menaxhimit Strategjik i kryesuar nga Kryetari i Këshillit të Qarkut ju paraqet raportin mbi përgatitjen dhe miratimin përfundimtar për Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023

Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur puna e GMS :

- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr.68 /2017“Per financat e vetqeverisjes vendore”
- Ligji nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.
- Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 30.07.2018.“Për procedurat standarte të Programit Buxhetor afatmesem te njesive te veteqeverisjes vendore”
- Udhëzimi i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 10 date 20.01.2020 “Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2021-2023”
- Udhëzim I Ministrisë se financave nr. 27 date 10.07.2020 “Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2021-2023”
- Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 16 Date 23.12.2019 “Per miratimin përfundimtar te Programit Buxhetor Afatmesem 2020-2022 per Keshillin e Qarkut Korce”
- Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 1 date 30.03.2020 “Mbi miratimin e tavaneve përgatitore per Programin Buxhetor Afatmesem 2021-2023”
- Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 5 date 30.07.2020 “Mbi përgatitjen dhe miratimin e kërkesave buxhetore per PBA 2021-2023”

Raporti i vlerësimit dhe parashikimit përfundimtar të PBA është hapi i radhës në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 dhe paraqitet sipas strukture së mëposhteme:

I. Organizimi i punës për hartimin e PBA –se 2021-2023

1. Ngritja e grupit të punës

Me Urdher te Kryetarit te Keshillit te Qarkut u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik per menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem 2021-2023, mbeshtetur ne programet dhe aktivitetet te miratuara ne Keshillin e Qarkut. Grupi i Menaxhimit Strategjik do te mbeshtetet ne kalendarin per hartimin e programit buxhetor afatmesem miratuar me Vendim te Keshillit te Qarkut nr. 17 date 23.12.2019.

2. Ndarja e kuotave sipas programeve

Ne drejtimin e Kryetarit rte GMS, grupi i punes ka punuar per planifikimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2021-2023 mbeshtetur ne:

- Mundesite reale te realizimit te burimeve te te ardhurave, si kusht per financimin e shpenzimeve.
- Analizen e realizimit te buxhetit ne dy vitet paraardhese si dhe ne realizimin e pritshem te tij per vitin 2020.
- Ritjen e lejuar te transfertes se pakushtezuar te parashikuar ne Udhezimin e Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 27 date 10.07.2020 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2021-2023" si dhe miratimin e transfertes se pakushtezuar per vitin 2021.
- Programi i aktiviteteteve per vitin 2020 si dhe parashikimi i tyre per vitin 2021 per institucionin e Keshillit te Qarkut te lidhura me objektivat e zhvillimit te qeverisjes vendore.
- Parashikimi i pritshem i realizimit te kontratave per implementimin e Projekteve te fituara me fonde te Bashkimit European ne kuader te Programeve te Bashkepunimit nderkufitar IPA CBC Greqi – Shqiperi 2014-2020 dhe 2021-2027.
- Normativat e lejuara te shpenzimeve te miratuara me akte ligjore e nenligjore.

Ne zbatim te Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 27 date 10.07.2020 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2021-2023", eshte percaktuar vlere e transfertes se pakushtezuar per periudhen 2021-2023 perkatesisht per sejcilin vit me nje ritje prej 0 % per 2021, 9.09 % per 2022 dhe 5 % per 2023 kundrejt vitit paraardhes. Theksojme se krahasuar me Udhezimin e Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 10 per miratimin e tavaneve te te ardhurave, kemi nje ndryshim ne nivelin e transfertes se pakushtezuar, e lidhur kjo edhe me situata e krijuara ne kushtet e Pandemise Covid 2019. Keshtu per vitin 2021 niveli i transfertes se pakushtezuar do te jete i njejte me vitin 2020. Per dy vitet ne vazhdim kjo ritje eshte me e ndjeshme.

Lidhur me planifikim e transfertes se kushtezuar (fondet e deleguara per DAMT ne qark) grupi i punes, duke patur parasysh edhe aktivitetin e kesaj drejtorie si dhe nivelin e ritjes se transfertes se pakushtezuar, propozon qe ritje e ketij treguesi te jete ne nivelet e ritjes se transfertes se pakushtezuar. Lidhur me planifikimin e te ardhurave te vete institucionit, grupi i punes mori per baze nivelet e te ardhurave te miratuara me vendimin e Keshillit te Qarkut nr. 1 date 30.03.2020 "Per miratimin e tavaneve pergatitore per programin buxhetor afatmesem". Gjithashtu rritja e nivelit te te ardhurave perkon edhe me planifikimin qe ju eshte bere atyre ne miratimin e PBA 2020-2022. Te ardhurat e veta perbehen nga kontributi financiar i bashkive dhe te ardhurat nga tarifat e sherbimeve qe ofron keshilli i qarkut. Aktualisht Keshilli i Qarkut ofron tarifa vetem nga DAMT dhe shume rralle nga arkivi i Urbanistikes.

Per vitin 2021 jane planifikuar qe do te perdoren edhe fonde te trasheguara qe mbeten nga viti 2020 me vlere rreth 43.7 milion leke.

Pjese e diskutimit ishin edhe projekt idete per aktivitetet qe do te planifikohen ne vitet ne vazhdim me synim arritjen e objektiveve te Keshillit te Qarkut. Hartimi i kerkesave buxhetore per tre vitet e ardheshme do te sherbeje si tregues kryesor per planifikimin e shpenzimeve sipas programeve dhe aktiviteteteve ne permbushje te objektiveve te Keshillit te Qarkut, kjo e lidhur edhe me Programin Buxhetor Afatmesem

2020-2022 perfundimtar te miratuar ne Keshillin e Qarkut ne Dhjetor 2019 . Disa nga objektivat kryesore te Keshillit te Qarkut te cilat jane mare ne konsiderate ne hartimin e Programit Buxhetor Afatmesem jane si me poshte:

- *Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.*
- *Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korce.*
- *Pjesemarija ne Programet nderkufitare e me gjere dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.*
- *Nxitjen e bashkëpunimit midis njesive te qeverisjes vendore te Rajonit, si dhe bashkëpunimin nderrajonal.*
- *Permirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.*
- *Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njesive përbërëse të tij, në procesin e Integritimit European.*

Planifikimi i shpenzimeve buxhetore per tre vitet e ardhme eshte bere mbi bazen edhe te orientimeve te Udhezimit nr. 27 date 10.07.2020.

Niveli i pagave dhe sigurimeve shoqerore eshte lene ne nivelin e vitit 2020.

Shpenzimet operative jane planifikuar me nje ulje rreth 15 % per cdo vit. Ne kete ze eshte patur parasysh situata e krijuar nga Pandemia Covid 19 si dhe ulja e nivelit te borxhit te trasheguar sipas palnifikimit.

Shpenzime per financime per te trete jane ne nivelin e vitit 2020, ketu jane planifikuar pjesemarija e Keshillit te Qarkut ne projekte te perbashketa me organe te ndryshme me fokus permiresimin e jetes sociale te komunitetit.

Shpenzimet per investime jane planifikuar ne te njejtin nivel per te tre vitet. Peshen kryesore ne kete ze e zenene investime ne pjesemarije ne projekte te bashkive te Qarkut per permiresimin e infrastruktures ne keto bashki. Kjo eshte nje nisem qe ka nisur nga viti 2018 dhe do te vazhdoje edhe per tre vitet e ardhshme.

Shpenzime per pjesemarije ne Programet IPA me projekte te fituara me fonde te Bashkimit European. Per vitin 2021 do te vazhdojne financimi i kater projekteve ne proces, si dhe projekti i ri qe eshte finalizuar. Ne dy vitet e tjera jane planifikuar fonde per bashkefinacim ne Projekte te tjera qe presim te finalizohen. Gjithashtu per vitin 2021 eshte planifikuar edhe nje limit prej 40 milion leke qe do te sherbeje per disbursimin e fondeve te Bashkimit European ne llogari te institucionit per pjesen qe do te rezoltoje teper ne perfundim te performances per sejcilin projekt.

Shpenzimet per Drejtorine e Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes jane me fonde nga transferta e kushtezuar. Niveli i planifikimit te tyre eshte bere gati ne nje nivel me vitin 2020.

Ne total buxheti per Programin Buxhetor Afatmesem 2021-2023 eshte parashikuar si me poshte:

Viti 2021	114634 mije leke
Viti 2022	78479 mije leke
Viti 2023	81636 mije leke

Bashkengjitur ketij informacioni eshte dokumenti i Instrumentit te Planifikimit Financiar per PBA 2021-2023.

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Kryetar i Keshillit te Qarkut

Drejtore e Finances

Shef i Kabinetit, Keshilltar Juridik

Keshilltare per Projektet e Bashkimit European

Specialist per Urbanistiken e Mbrojtje e territorit

Specialist per Sherbimet e Burimet Njerezore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TE BUXHETIT TE VITIT 2020
PER PERIUDHEN 8/mujori i pare

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” është hartuar “Raporti për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2020 për periudhën 8/mujore”

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2020 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshtë:

- *Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligjin nr.68 /2017“Per financat e vetëqeverisjes vendore”*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 88/2019“ Për buxhetin e vitit 2020”*
- *Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018.“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.2 dt20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit2020“.*
- *Ne Vendimin e Keshillit të Qarkut nr.15 date 23.12.2019 “Per miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut per vitin 2020”*

Raporti paraqet punën e administratës të Këshillit të Qarkut Korçë në zbatimin e politikave të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut si në realizimin e burimeve të të ardhurave ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një ritje të cilësisë të shërbimeve të ofruara. Ai përqëndrohet kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më të mirë të shpenzimeve për 8 mujorin 2020.

CILI ËSHTË MISIONI I QARKUT KORÇE

Misioni i Këshillit të Qarkut Korçë është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore në plotësim të funksioneve të veta ligjore, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Këshilli i Qarkut ofron bashkëpunimin dhe koordinimin midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, si dhe bashkëpunimin e kordinimin e politikave midis njësive të qeverisjes vendore të rajonit.

Këshilli i Qarkut Korçe ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithë partnereve lokale e rajonale për pjesëmarrje në projekte gjithëpërfshirëse. Këshilli i Qarkut ofron partneritetin e tij për pjesëmarrje në Programet ndërkufitare të financuara nga Bashkimi Europian etj, me synim zhvillimin ekonomik social të Rajonit dhe ritjen e cilesisë së shërbimeve për komunitetin.

OBJEKTIVAT E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2020

Disa nga objektivat kryesore të Këshillit të Qarkut për vitin 2020

- Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qëndrore.
- Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korçe.
- Pjesëmarrja në Programet ndërkufitare e me gjere dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.
- Nxitjen e bashkëpunimit midis njesive te qeverisjes vendore te Rajonit, si dhe bashkëpunimin ndërrajonal.
- Përmirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.
- Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njesive përbërëse të tij, në procesin e Integritimit Europian.

REALIZIMI I BUXHETIT TE KESHILLIT TE QARKUT PER PERIUDHEN 8/mujore

Zbatimi i Buxhetit të Këshillit të Qarkut për periudhën 8/mujore ka ecur në kushte normale, kjo si rezultat i një planifikimi të mbështetur mbi burime reale të të ardhurave të vetë Institucionit si dhe një menaxhim të mirë të shpenzimeve në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe programeve të planifikuara për këtë vit.

Burimet e financimit :

- Të ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

Funksionet kryesore të strukturave financiare :

- Për funksionet e veta
- Për funksionet e përbashkëta
- Për funksionet e deleguara

➤ Analiza e realizimit te te ardhurave per periudhen 8/mujore

Të ardhurat e veta per periudhen 8/mujore jane parashikuar sipas metodës dinamike duke marrë në konsiderate të dhënat e ecurisë së arkëttimeve të viteve të fundit, dhe realizimit faktik të vitit 2019.

Llojet e të ardhurave që ka arkëtuar institucioni gjatë periudhes kanë qënë si mëposhtë:

- Të ardhura nga tarifat e ndryshme që institucioni ka të përcaktuara me akte ligjore dhe me vendime të Këshillit të Qarkut ne funksion te sherbimeve qe ai i ofron komunitetit.
- Të ardhurat e trashëguara nga viti buxhetor 2019, të cilat janë planifikuar te perdoren per financimin e shpenzimeve te planifikuara per kete vit buxhetor

Gjate kesaj periudhe Institucioni përgjithësisht ka ecur drejt përmbushjes së objektivave dhe parashikimeve të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut duke patur parasysh nje balance te drejte midis burimeve te financimit dhe realizimit te shpenzimeve ne permbushje te aktiviteteve dhe programeve te miratuara per vitin 2020.

Te ardhurat ne buxhetin e Keshillit te Qarkut per kete periudhe jane realizuar si me poshte:

ne 000/leke

Te ardhurat	Plani 8/M 2020	Fakti 8/M 2020	Realizim ne %	Diferenca ne leke
1. Transferta e pakushtezuar	43051	43051	100	0
2. Te ardhurat e veta	400	180	45	220
a. Te ardhura nga tarifat	400	180	45	220
b. Kontributi financiar i bashkive	0	0	0	0
3. Te ardhura te trashëguara 2019	67227	67227	100	0
4. Transferta e kushtezuar	4691	4691	100	0
Totali 4/M 2020	115369	115149	99.81	220

Per 8/mujorin, te ardhurat ne buxhet jane realizuar ne vlere 115149 mije leke ose 99.81% e planit, te ndara sipas natyres jane:

Transferta e pakushtezuar me vlere 43051 mije leke eshte realizuar 100%, kjo e ardhur vazhdon te jete burimi kryesor i te ardhurave dhe eshte perdorur per financimin e funksioneve te veta ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi. Celja e saj eshte bere ne mbeshtetje te planit fillestar te buxhetit te ndare ne tremujore. Gjate periudhes nuk ka patur shtesa apo pakesime ne kete ze te buxhetit.

Te ardhurave te vete institucionit per 8/mujorin jane realizuar ne vlere 180 mije leke ose 45 % e planit, me nje diference ne buxhet 220 mije leke. Per kete periudhe jane parashikuar vetem realizim i te ardhurave nga sherbimet qe ofron Keshilli i Qarkut per qytetaret. Realizimi ne nivel te ulet lidhet edhe me periudhen mars - maj ku institucioni ka punuar me orare te reduktuara per shkak te situates se krijuar nga COVID 19. Gjithashtu edhe levizja e qytetareve per kete periudhe ka qene e kufizuar. Te ardhurat nga kontributi financiar i bashkive per kete periudhe nuk jane planifikuar.

Te ardhurat e trashëguara nga viti 2019 ne total jane ne vlere 67.2 milion leke leke (grant + te ardhura), te cilat jane planifikuar te perdoren sipas vendimeve te Keshillit te Qarkut. Keto fonde jane ne nivele te larta, jane akumuluar gjate kater viteve te fundit dhe jane planifikuar te perdoren kryesisht ne projektet IPA si per financimet e 15 % te pjesemarrjes ne buxhetet e Projekteve te fituara nga Programet IPA CBC 2014-2020 si dhe fonde te mjaftueshme per parafinancimet. Implementimi i ketyre projekteve ka filluar ne vitin 2018 dhe financimi i tyre do te jete ne 3 vitet ne vazhdim sipas parashikimit ne kontratat perkatese.

Te ardhurat e realizuara ne total jane perdorur per financimin e funksioneve te veta te percaktuara si me poshte:

- Pagat e personelit,
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit.
- Për shpenzime operative
- Investime
- Bashkefinancim Projekte te BE
- Investimene infrastrukture sipas propozimeve te bashkive dhe miratimit ne Keshillin e Qarkut

Te ardhura nga fondet e kushtezuara per periudhen 8/mujore 2020

Gjatë periudhes 8/mujore, Këshilli i Qarkut për përmbushjen e funksioneve të deleguara, ka përfituar nga buxheti i shtetit fonde të nga buxheti i kushtezuar në shumën prej **4691 mije** lekë. Gjate periudhes nuk kemi ndryshime ne kete ze te buxhetit. Keto fonde jane perdorur per financimin e aktivitetit te Drejtorise se Administrimit dhe Mbrojtjes ne Qark e cila eshte funksion i deleguar.

➤ Analiza e realizimit te shpenzimeve per periudhen 8/mujore

Shpenzimet e buxhetit gjatë kesaj periudhe janë realizuar në shumën prej **57315 mije lekë** nga **114969 mije leke** te planifikuara ose **49.86 %**.

Nga totali i shpenzimeve per periudhen 8/M, shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **22312 mije leke ose 69.36%** ndaj planit prej **32171 mije leke** sipas programeve te miratuara per administraten e keshillit te qarkut dhe drejtorine e DAMT ne qark. Mosrealizimi lidhet me situaten e krijuar per muajit Mars-Prill per shkak te rregullave te vendosura ne situate emergjete nga COVID 19.

Shpenzimet kapitale për periudhen 8/mujore jane realizuar ne vlere **34944 mije leke ose 51.3 %** te planit prej **68135 mije leke**. Edhe ne kete ze te shpenzimeve mosrealizimet kane ardhur per arsytet e permendura me lart. Me stabilizimin e situates dhe kalimin ne kushte normale, do te vazhdoje realizimi i prokurimeve dhe zbatimi i te gjitha objekteve te planifikuara per kete periudhe.

Realizimi i shpenzimeve per periudhen 8/mujore paraqiten si me poshte Ne 000/leke

Nr.	Emertimi sipas Programeve	Plan8/M	Fakt8/M	Diferenca	% realizim
1	Administrata – Programi 01110	38520	19015	19505	49.37
	Paga personeli	10109	8771	1338	87.77
	Sigurime shoqerore e shendetsore	2000	1425	575	71.25
	Shpenzime operative, keshilltare e vendime gjyqesore	9720	3793	5927	39.03
	Transferta korente te brendshme	5610	4970	640	88.6
	Nga keto:		0		
	- Bashkia Korce Projekti “Qendra ditore per moshen e trete”	3000	3000	0	100
	- Projekti “Korca Open Air “	200	200	0	100
	- Shoqatat e te verberve	500	410	90	82

	- Qendra Kujdesit Shendetsor Familjar – Kujdesi Paliativ	400	400	0	100
	- Projekti me Spitalin Rajonal Korce	960	960	0	100
	Transferta tek individet, familjaret	41	41	0	100
	Investime kapitale	11040	16	11024	0.15
2	Drejt.DAMT –Programi 01160	4691	3313	1378	70.63
	Paga personeli	3840	2763	1077	72
	Sigurime shoqerore e shendetsore	583	458	125	78.6
	Shpenzime operative	268	92	176	34.3
3	Bashkefinancim ne Projekte me fonde Bashkimit Europian-Programi 08250	10907	0	10907	0
4	Projekti IPA – Wincome – Programi 04220	1153	58	1095	0
5	Projekti IPA – Waste Rreact – Programi 05100	1822	0	1822	5.03
6	Projekti IPA – Save Water-Programi 06330	57095	34928	22167	61.2
7	Projekti IPA – Save Safe Water – Programi 06330	281	0	281	0
8	Fondi rezerve	500	0	500	0
	Total KESHILLI I QARKUT	114969	57315	57654	49.86

Analiza analitike e shpenzimeve përperiudhen 8/mujore, (për Administratën)

Buxheti i periudhes 8/mujore per administraten e Keshillit te Qarkut eshte realizuar ne nivelin **49.37 %** dhe ne vlere absolute **19015 mije** leke nga **38520mije** leke te programuara. Menaxhimi i buxhetit per kete periudhe eshte bere sipas programeve te miratuara ne plan, duke ruajtur nje raport te drejte ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe duke patur nje bilanc pozitiv te pagesave brenda limiteve te miratuara nga Keshilli i Qarkut.

Duke analizuar në mënyrë analitike sipas strukturave përdorimi i fondeve për shpenzime që ka patur në dispozicion administrata e Këshillit të Qarkut per kete periudhe rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente per Administraten jane realizuar ne nivelin 18999 mije leke nga 27480 mije leke te planifikuar ose 69.14 % sipas programit buxhetor. Ecuria e shpenzimeve korente per paga, sigurime shoqerore eshpenzime operative ka qene ne perpjestim te drejte per cdo muaj duke permbushur te gjitha nevojat dhe detyrimet per funksionimin normal te Administrates. Mosrealizimi eshte kryesisht ne shpenzimet per vendime gjyqesore dhe detyrime te trasheguara si dhe pjeserisht ne aktivitetet qe do te mbeshteste Keshilli i Qarkut per kete periudhe. Kjo lidhet edhe me situaten e krijuar ne periudhen Mars – gusht. Financimi i tyre do te vazhdoje ne periudhen aktuale.
- Shpenzimet kapitale kane qene te planifikuara ne vlere 11040 mije leke dhe jane financuar vetem 16 mije leke te lidhura me likujdimin e nje detyrimi te trasheguar te deklaruar te borxhi. por nuk eshte realizuar dhe prokuruar asnje objekt i planifikuar, kjo per shkak te situates dhe bllokimit te procedurave te prokurimit. Aktualisht kane filluar procedurat e prokurimit te nje pjese te objekteve.

a. Shpenzime për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)

Realizimi i shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore per periudhen 8/mujore për personelin është kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Administrata perbehet nga 13 punonjës, te cilet paguhen me nivelin e pagave te miratuara ne Keshillin e Qarkut. Fondet per financimin e ketyre shpenzimeve jane nga Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2020. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për kete periudhe eshte ne vleren 10196 **mije leke ose 84.21 %** ndaj **12109 mije leke** te miratuara sipas programit. Mos realizimi lidhet vetem me momentin e planifikimit, pasi plani per kete periudhe eshte me i madh se ne katermujorin e fundit.

b. Shpenzimet Operative, keshilltare dhe vendime gjyqesore (Artikulli 602)

Realizimi i shpenzimeve operative, keshilltare dhe vendime gjyqesore per kete periudhe eshte bere ne mbeshtetje te programeve dhe aktiviteteve te miratuara ne Keshillin e Qarkut. Niveli i realizimit te ketyre shpenzimeve eshte 3793 mije leke ose 39.03 % ndaj 9720 mije leke te miratuara. Ne kete nivel realizimi ka ndikuar periudha mars- qershor , periudhe ne te cilen nuk u lejuan prokurime dhe financimi i shpenzimeve ishte vetem per shpenzime me imediate qe lidheshin me aktualitetin. Nga analiza niveli i shpenzimeve rezulton si me poshte:

- Shpenzime per blerje dokumentacioni specifik dhe materilae pastrimi jane realizuar ne masen 131.3 mije leke
- Shpenzime per energji, uje telefona fix e celulare e shpenzime postare Art. 602.2 jane realizuar ne nivelin 514.2 mije leke, nga te cilat 120 leke jane shpenzime te trasheguara.
- Shpenzime per karburant, riparim auto dhe siguarçione te mjeteve Art. 6023 jane realizuar ne nivelin 794.8 mije leke nga te cilat 100.8 mije leke jane shpenzime te vitit 2019 dhe te financuara ne janar 2020.
- Shpenzimet per udhetim e dieta Art. 6024 jane realizuar ne nivelin 358.7 mije leke
- Shpenzime per pagesa te vendimeve gjyqesore Art. 6027 jane realizuar ne nivelin 1294.5 mije leke te cilat jane shpenzime per detyrime te trasheguara te parashikuara ne borxhi.
- Shpenzime per pagesen e shperblimit per anetaret e Kryesise te Keshillit te Qarkut Art. 6029 jane realizuar ne nivelin 588.7 mije leke
- Shpenzime te tjera operative, si aktivitete, honorare dhe tarifa vendore Art. 6029 jane realizuar ne nivelin 111 mije leke

Te gjitha shpenzimet jane bere sipas programit buxhetor te miratuar ne Keshillin e Qarkut per periudhen 8/mujore. Likujdimi i detyrimeve eshte bere edhe kundrejt amortizimit te tyre te parashikuar ne Programin Buxhetor Afatmesem 2020-2022, si dhe ne Vendimin e Keshillit te Qarkut nr. 15 date 23.12.2019 "Per miratimin e buxhetit te Keshillit te Qarkut per vitin 2020".

c. Shpenzimet për Pagesat e Transfertave të Brendshme (Artikulli 604)

Në këtë artikull përfshihen shpenzimet e planifikuara për transfertat e brendshme siç janë ato të Shoqatave të Verbërve të Qarkut Korce, kontribut financiar per Qendren e Sherbimit Paliativ Korce, pjesemarije ne Projektin e perbashket me Bashkine Korce " Qendra ditore te moshes se trete" si dhe ne Projektin e Aeronautikes Shqiptare "Korca Open Air", Projekti me Spitalin Rajonal Korce. Per kete periudhe jane realizuar dhe financuar te gjitha projektet e planifikuara. Per shkak te periudhes Covid 19 disa financime jane lene per periudhen ne vazhdim.

Financimi sipas zerave eshte:

- Pjesemarija ne projektin e perbashket me Bashkine Korce "Qendra ditore te moshes se trete" eshte realizuar 100 % ose 3000 mije leke te programuara.

- Kontributi financiar per Projektin e Aeronautikes Shqiptare "Korca Open Air" me vlere 200 mije lek
- Shoqata e te Verberve me vlere 410 mije leke
- Qendra e Kujdesit Shendetsor Paliativ Korce me vlere 400 mije leke
- Projekti me Spitalin Rajonal Korce me vlere 960 mije leke

c. Shpenzimet Kapitale Investimet (Artikulli 230-231)

Përperiudhen 8/mujoreProgrami i investimeve i miratuar me Vendim te Keshillit te Qarkut eshte **11040mije lek**edhe nuk eshte realizuar asnje objekt per aresye qe i permendem me lart. Ne kete artikull eshte likujduar vetem nje detyrim i trasheguar me vlere 16 mije lek.

Analiza analitike e shpenzimeve për8/M per funksionet e deleguara (DAMT ne qark)

Keshilli i qarkut ne permbushje te funksioneve te deleguara si funksioni i Drejtorise te Administrimit dhe Mbrojtjes te Tokes ne qark, ka te programuar ne Buxhetin e tij edhe fonde nga transfertat e kushtezuar, te cilat delegohen nga Buxheti i Shtetit.

Gjatë kesaj periudhe, shpenzimet e përgjithshme për funksionimin e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë realizuar në shumën 3313mije lekë nga 4691 mije lekë te planifikuara. Shpenzimet e bera per kete funksion jane financuar 100 %. Ne kete mosrealizim ka ndikuar mungesa e nje punonjesi per kete periudhe.

Shpenzime për Pagat dhe Sigurimet Shoqërore të Punonjësve (Artikulli 600+601)

Shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore perperiudhen 8/M për punonjësit e Drejtorisë të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), janë kryer në zbatim të strukturës organike të miratuar nga Ministria e linjës si dhe nivelit te pagave te miratuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

Për kete periudhe numri i punonjesve per kete drejtori ka qene 6 punonjes nga 7 te planifikuar. Realizimi i fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore eshte ne vleren **3221 mije lekë**, kundrejt fondit të programuar ne vlere **4423 mije leke** ose e shprehur në përqindje në **73%**.Kjo lidhet me mungesen e nje punonjesi per per kete periudhe. Gjithashtu ne kete ze ka nje planifikim me nje rezerve te vogel.

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes (Artikulli 602)

Per periudhen vlere e shpenzimeve operative eshte planifikuar 268 mije leke dhe realizimi i tyre eshte ne nivelin 92 mije leke, kjo lidhet me situatat e krijuara dhe mos realizimin e prokurimeve te planifikuara per kete drejtori. Per kete periudhe jane financuar vetem shpenzime per energji elektrike dhe uje ne vlere 64.5 mije leke, shpenzime postare ne vlere 9.4 mije leke dhe tarifa vendore ne vlere 17.5 mije leke.

Realizimi i buxhetit te Keshillit te Qarkut per pjesemarije ne Programe nderkombetare

Per periudhen 8/mujore ne Programin buxhetor te Keshillit te Qarkut eshte planifikuar buxhet per financimin e projekteve me fonde nga Bashkimi European. Keshilli i Qarkut ne zbatim te funksioneve te percaktuara me akte ligjore e nenligjore ka mare pjese gjeresisht ne aplikimet per projekte sipas Programeve te bashkepunimit nderkufitar IPA CBC si dhe ne Programe te tjera nderkufitare. Aktualisht jane finalizuar 4 projekte me nje vlere totale prej rreth 1050 mije euro si me poshte:

- Save – Water me vlere 802594.00 euro
- Waste React me vlere 93967.59 euro

- Wincome me vlere 61773.66 euro
- SaveSafe Water me vlere 52951.02 euro

Per keto projekte jane nenshkuar kontratat me partneret dhe ka filluar implementimi i tyre qe ne vitin 2018. Financimi i shpenzimeve per keto projekte ka filluar ne vitin 2019 dhe do te vazhdoje edhe per dy vite sipas afateve te parashikuar ne kontratat perkatese. Per kete qellim ne Buxhetin e Keshillit te Qarkut per vitin 2020 jane planifikuar 74292 mije leke (grant + te ardhura) fonde per bashkefinansim nga te cilat 71258 mije leke janeplanifikuar vetem per periudhen 8/mujore. Realizimi i tyre eshte ne nivelin 34986 mije leke. Peshen kryesore ne planin e kesaj periudhe e kapin investimet ne Projekti SAVE WATER, te cilat jane kane filluar te zbatohen ne 4/mujorin e tretete vitin 2019 dhe do te vazhdojne edhe per 2 vitet ne vazhdim. Ecuria e realizimit dhe financimit te projekteve eshte bere kundrejt kontratave te nenshkuara dhe afateve te percaktuara ne to. Keto programe kane nje periudhe zbatimi 2 dhe 3 vjecare.Gjithashtu ne zbatim te Udhezimit plotesues per zbtimin e buxhetit te vitit 2020, per llogari te buxhetit per projektet jane planifikuar edhe 40 milion leke ne kapitullin 2 si limit per realizimin e disbursimit te fondeve te projekteve nga bankat e nivelit te dyte ne llogari te Keshillit te Qarkut prane Deges se thesarit, kjo ne momentin e perfundimit te projekteve.

Kryetar i Keshillit te Qarkut

Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 11, dt. 18/12/2020

MBI MIRATIMIN E KALENDARIT PËR HARTIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024 DHE BUXHETIT VJETOR 2022 PËR KËSHILLIN E QARKUT

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.9936, dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 dt. 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratoje Kalendarin për procesin e hartimit të Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar dhe Buxhetit vjetor 2022 për Këshillin e Qarkut Korçë.
2. Ngarkohet Kryetari i Keshillit te Qarkut, Ekipi për Menaxhimin e Programeve dhe Administrata e Këshillit të Qarkut për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij nga 01 Janari 2021.

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI

Konceptoi L.Pleqi
Juristi Gj. Kristo
Sek K.Qarkut B. Muço



Aneksi 2

KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2024 DHE BUXHETIT VJETOR 2021

Fazat	Nr	VEPRIMI PERKATES	Struktura Pergjegjese	Afati
FAZA I	Hapi I	Përgatitja dhe shpërndarja e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe I buxhetit vjetor	Kryetari dhe struktura përgjegjëse për buxhetin	Deri ne 31 dhjetor 2020
	Hapi II	Përgatitja e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024	GMS	Deri me 31 Janar 2021
		Paraqitet për shqyrtim e miratim në këshill raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024	Kryetari	Deri me 1 Mars 2021
		Miratimi i raportit të vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave.	Këshilli i Qarkut	Deri me 1 Mars 2021
	Hapi III	1. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës së Misionit . 2. Shqyrtimi dhe miratimi i strukturës së programeve. 3. Miratimi i kalendarit të brendshëm për realizimin e procedurave të PBA -së.	Mbledhja e I GMS	Deri me 5 Mars 2021
		Përgatitja e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm.	Mbledhja e II GMS	Deri me 10 Mars 2021
		Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Këshilli i Qarkut	Deri me 15 Mars 2021
	Hapi IV	GMS harton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit dhe kryetari e miraton dhe e shpërndan tek sektorët me: a) përcaktimin e programeve buxhetore dhe të ekipit të menaxhimit të programeve përkatëse; b) tavanet përgatitore të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet e ardhshme; c) afatet e përgatitjes së kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	GMS/Kryetari	15-20 Mars 2021
	Hapi V	a. Përgatitja e nje kalendarit të detajuar për fazën e parë të hartimit te kërkesave buxhetore në përputhje me kalendarin bazë të miratuar nga KQ. b. Rishikon strukturën e programeve te NJQV dhe nqs është e nevojshme bën propozime për ndryshime.	Nëpunësi zbatues në rolin e Sekretarit te GMS përgatit për Kryetarin dhe GMS	
		c. Dërgon kopje të udhëzimit vjetor të PBA dhe kalendarin të të gjithë anëtarët e GMS		
	Hapi VI	Pas shpërndarjes së tavaneve përgatitore sipas programeve fillon përgatitja e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm sipas udhëzimit të miratuar nga Kryetari. Përgatitja e planeve të shpenzimeve , formulareve të propozimit të projekteve të investimeve dhe kërkesave për shpenzime shtesë për cdo program dhe dorëzimi tek Kordinatori i GMS. Hartimi i kërkesave buxhetore dhe të gjithë formave përkatëse. Hartimi i relacioneve shpegues për cdo program.	GMS/EMP	Deri 20 Maj 2021
		Dërgohet në Ministrinë e Financave dokumeti I parë i programit buxhetor afatmesëm ne forme elektronike dhe shkresore.	Kryetari	Deri 1 Qershor 2021
Ministria e Financave analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm dhe e sjell zyrtarisht në institucion.		Ministria e Financave	Deri 20 Qershor 2021	

FaZA II	Hapi I	Shqyrtimi dhe miratimi I dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm, duke u bazuar edhe mbi rekomandimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	Këshilli i Qarkut	Deri 30 Qershor 2021			
		Publikimi i dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 të miratuar.	Kryetari	1-5 Korrik 2021			
		Përgatitja e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi dhe hartimi i projekt vendimit për miratimin nga Këshilli i Qarkut me relacionin përkatës.	Kryetari	10 - 15 Korrik 2021			
	Hapi II	Këshilli miraton tavanet përfundimtare			Deri në 20 Korrik 2021		
			Kryetari i NJQV harton udhëzimin për përgatitjen e buxhetit dhe e shpërndan tek sektorët me: a) tavanet përfundimtare të shpenzimeve në nivel programi për tre vitet e ardhshme; b) afatet e përgatitjes së kërkesave të rishikuara të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Kryetari	20-25 Korrik 2021		
			Rishikimi i dokumentit të parë të Programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe përgatitja e materialit për miratim në Këshill.	EMP/GMS/Kryetari	1-10 shtator 2021		
		Hapi III	Miratimi i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 të rishikuar		Këshilli i Qarkut	Deri 15 Shtator 2021	
				Dërgimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 të rishikuar dhe të miratuar nga këshilli i qarkut, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MFE gjatë fazës së parë.	Kryetari	Deri 15 Shtator 2021	
				Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Deri 20 Tetor 2021	
			Hapi III	Hartimi I projektbuxhetit vjetor me tabelat përkatëse dhe relacionet për miratim në Këshill.		Sektoret/GMS/Sektori I Finances	Deri në 30 Nëntor 2021
					Pas marrjes së mendimeve përfundimtare dhe bashkërendimit me Projekt buxhetor vjetor, paraqitet për miratim në këshill Dokumenti përfundimtar i PBA 2022-2024	Kryetari	Deri në 30 Nëntor
					Propozojnë ndryshime të argumentuara të projektbuxhetit të paraqitur nga kryetari.	Këshilli i Qarkut	Deri 10 Dhjetor 2021
	Hapi III	Dokumenti përfundimtar I programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe buxheti i vitit të ardhshëm kalojnë për miratim në Këshillin e Qarkut.			Këshilli i Qarkut	Deri 25 Dhjetor 2021	
				Publikimi i dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqëruar	Kryetari	Deri 31 Dhjetor 2021	
				Një kopje e buxhetit vjetor vendor dërgohet në Ministrinë e Financave	Kryetari	Jo më vonë se 5 ditë nga Konfirmimi i tij	
		Publikimi i buxhetit vjetor me informacionin përkatës	Kryetari	Jo më vonë se 15 ditë nga miratimi në Këshill			

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana Verushi

